

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI
TË KUFIZUAR
EDIOL SHPK**

- Une Z. Eduart Sharka, shtetas Shqiptar , lindur me 09.01.1972 ne Lushnje, me adresë banimi : Durres , Lagja 18 kam vendosur të nënshkruajë Aktin e Themelimin e mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë "Shoqëria"), aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij akti.

Neni 1 - Emërtimi

Emërtimi i Shoqërisë është **EDIOL SHPK**

Neni 2 - Selia

Selia e Shoqërisë është: Lagja Stalla , Sukth i Ri , Durres

Neni 3 - Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar.

Neni 4 - Objekti i shoqërisë

Shoqëria ka për objekt:

-Prodhim tekstile, rrobaqepësi, Prodhim veshje per te rritur, import lendet se pare, hapje linjash prodhimi, import export reklamim/perfaqesim, tregtim dhe magazinim , tregti me shumice pakice edhe si agjent apo perfaquesues brenda dhe jashte vendit per veshje, Hapja e linjave te rrobaqepsise , fasoneri etj.

Neni 5 - Kapitali themeltar

5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është : 100,000 lekë.


5.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 1 kuotë, me vlerë nominale sipas kontributit të ortakut të vetëm në kapitalin themeltar të Shoqërisë percaktuar ne nenin 6 (gjashtë) të këtij Akti.

Neni 6 - Kontributet

6.1. Kontributi në kapitalin e shoqërisë është si më poshtë:

- Z. Eduart Sharka, shtetas Shqiptar , lindur me 09.01.1972 ne Lushnje, me adresë banimi : Durres , Lagja 18

të cilët i përket një kuotë me vlerë nominale Leke: 100,000 lekë që i korespondon



100% i kapitalit të Shoqërisë.

Neni 7 – Transferimi i kuotave

Kuotat i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

Neni 8 – Administrimi

8.1 Me këtë akt emërohet 1 (një) Administratorë i Shoqërisë personi si më poshtë:

- Z. Eduart Sharka, shtetas Shqiptar, lindur me 09.01.1972 ne Lushnje, me adresë banimi: Durres, Lagja 18, i cili emërohet për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.
- 8.2 Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 95 të ligjit nr. 9901, datë 14 prill 2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare” dhe nenit 14 të Statutit.
- 8.3 Administratorit i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer të gjitha formalitetet dhe veprimet e parashikuara për themelimin e Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim, Administratori, mund t'u drejtohet për ndihmë të tretëve ose konsulentëve të cilëve mund të delegojnë në tërsi ose pjesërisht kryrjen e aktivitetit të sipërpërmendur.
- 8.4 Administratori është gjithashtu i autorizuar të veprojë në emër të Shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Ai është gjithashtu i autorizuar, të firmosi të gjitha aktet dhe të marrë përsipër detyrime në emër të Shoqërisë që rrjedhin prej momentit të regjistrimit të saj si edhe ka të drejtë t'i delegojë kompetencat e tij personave të tjera.

Neni 9- Gjuha

9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

9.2 Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin e akteve si më lartë, versioni në italisht do të jetë i vetmi version ligjërisht detyrues.

Neni 10 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 10.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti si edhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve (përveç atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.
- 10.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ato do t'i besohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.



Ortaku i vetem

EDUART SHARKA

20.09.2024

/

